

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BIZ.NES” SH.P.K.

Sot, më date **14.09.2023**, une i nënshkruari:

- **Antonio Pagano** lindur me **13/01/1969**, ne Scafati (SA) dhe me residence ne Scafati (SA), shtetas Italian i identifikuar nepermjet ID me numer **CA20477DP**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**BIZ.NES**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**BIZ.NES**” SH.P.K.

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Fier, Lushnje, Lagjja Kadri Qystri, rruga Fan Noli, pallat me Nr.pasurie 11/189-N2, zone kadastrale me Nr.8571, ne katin e pare..

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: sheashpk01@yahoo.it
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3


-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

Sherbime ne favor te kompanive dhe partnerve strategjik per sherbime konsultatice te asistuara te korporatave , administrative , tregtare , sigurimore . Konsulence per investime te individeve , kompani publike apo private, organet publike dhe private kombetare dhe nderkombetare. Sherbime te menaxhimit



strategjik te organizatave , konsult e asistuar dhe asistence per pjesmarrje ne njoftimet e konkurrencave locale , rajonale , kombetare dhe nderkombetare. Furnizim te sherbimeve logjistike, aktivitetet e marketingut dhe kerkimet e tregut si dhe punime promocionale e reklama te produkteve te perfaqsuara dhe jo. Agjent shitjesh dhe perfaqsimi ne sektorin ushqimor , ne sektorin e produkteve plastike dhe ekologjike , import eksporti dhe perpunim i produkteve plastike , pllakave , kaneqeve , xhamit dhe materialeve te ngjashme ose derivatet e lendeve te para, mineralet , perimet dhe kafshet , si dhe produktet e finuara e produktet gjysme te perfituara , sipas perpunimit te pjesshem dhe total nga keto lende te para per ruajtjen e paketimin e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore dhe per vete produktet jo direkt. Operacionet tregtare , industrial , letrave te vleres dhe pasurise te paluajtshme . Zhvillimi i aktiviteteve si E Commerce , Freelancing . etje.

-Megjithate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Antonio Pagano** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit


Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët janë te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;



- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi


Administrator i shoqërisë emërohet z. **Antonio Pagano** lindur me **13/01/1969**, në Scafati (SA) dhe me rezidence në Scafati (SA), shtetas Italian i identifikuar nepermjet ID me numer **CA20477DP**, madhor me zotesi të plote juridike për të vepruar, i zgjedhur për një periudhë **5** vjecare me të drejta rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të përcaktuara qartë në statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.



Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE

ANTONIO PAGANO

